



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1410/8 prot.

Datë 12.06.2026

V E N D I M
Nr. 794/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.06.2026 me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “INSTANT.AL” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PC STORE” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durrës, me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës..

Ankimues: “INSTANT.AL” SHPK me NIPT (L81506043D), me adresë: Rruga “Ali Demi” përballë Fushës së Zezë, Tiranë, zona kadastrale 8150.

“OPTIMA COMMUNICATION” SHPK me NIPT (K71903025A), me adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.

“PC STORE” SHPK me NIPT (L01606034A), me adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.5. Ankimuesit kanë plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05-12-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II.2. Në datën 02.02.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor më datë 09.02.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK 9343900.00 lekë Skualifikuar

2.“PC STORE” SHPK	9600000.00 lekë Skualifikuar
3.“ATOM” SHPK	11800000.00 lekë Skualifikuar
2.“OPTIMA COMMUNICATION” SHPK	12400000.00 lekë Skualifikuar
4.“INSTANT.AL” SHPK	13270000.00 lekë Skualifikuar
6.“Cactus” SH.A	13524753.67 lekë Skualifikuar

II.4 Në datën 11.02.2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit dhe nëpërmjet Buletini Nr. 14 datë 16 Shkurt 2026 të APP, me arsyen e anulimit:

X në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

II.5. Në datën 15.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 478/2026 protokoli, datë 16.02.2026 e operatorit ekonomik BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.478/1 prot, datë 16.02.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se me shkresën e protokolluar me tonën nr.478/2, datë 17.02.2026, janë dorëzuar informacione shtesë nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK. Gjithashtu me shkresën nr.4283/31, datë 17.02.2026 protokolluar me tonën nr.478/3, datë 17.02.2026, janë dorëzuar argumente shtesë nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.478/4, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.478/5, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.10. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka përcjellë me shkresën nr. 703 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 478/6 prot., datë 02.03.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.11. Në datën 17.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6336 dhe me nr. 494/2026 prot., datë 17.02.2026 e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.12. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.494/1 prot, datë 17.02.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK si dhe lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “IdealDevs Corporation” shpk, “Pc store” shpk, “ATOM” shpk, “OPTIMA COMMUNICATION” sh.p.k, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.13. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.494/2, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.14. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.494/3, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “IdealDevs Corporation” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.15. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 704 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr.494/4 prot., datë 02.03.2026, vendimin e KSHA-së së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës se sipërcituar.

II.16. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.499/1 prot, datë 18.02.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.17. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.499/2, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.18. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 705 prot., datë 26.02..2026, protokolluar me tonën me nr.499/3 prot., datë 02.03.2026, vendimin e KSHA-së së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës se sipërcituar.

II.19. Në datën 17.02.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 504/2026, datë 18.02.2026 dhe numër ankimi elektronik A/2026/6339, datë 18.02.2026, e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF71079-12- 04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02- 2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.20. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.504/1 prot, datë 18.02.2026, lidhur me

vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK. Gjithashtu operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, kërkon lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “IdealDevs Corporation” shpk, “Pc store” shpk, “ATOM” shpk, “Instant” sh.p.k, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK dhe operatorit ekonomik “PC Store”, në këtë procedurë prokurimi.

II.21. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.504/2, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.22. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 706 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr.504/3 prot., datë 02.03.2026, vendimin e KSHA-së së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës së sipërcituar.

II.23. Në datën 03.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 330/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Instant” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
5. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
6. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, nga operatori ekonomik

“Instant” SHPK, nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK si dhe nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK.

8. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

9. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

II.24. Me shkresën nr. 800/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën nr. 478/11 prot., datë 13.03.2026, autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 330/2026 datë 03.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II.25. Në datën 17.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 404/2026, ku vendosi:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.*

2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

II.26. Në datën 05-05-2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit dhe nëpërmjet Buletini Nr. 31 datë 11 Maj 2026 të APP, me arsyen e anulimit:

X në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;.

II.27. Në datën 07.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 1410 protokolli, datë 07.05.2026 e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.28. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1410/1 prot, datë 07.05.2026.

II.29. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik, ka përcjellë me shkresën nr. 1571 prot., datë 11.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1410/2 prot., datë 14.05.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Në vijim të ankesës së paraqitur nga OE INSTANT.AL, për procedurën e prokurimit me objekt "Digital Port" me Nr. Aplikimi të Ankesës online A/2026/6631, Autoriteti Portual Durrës bazuar ne Relacionin Vendimmarrës Nr.1515 Prot, datë 05.05.2026, ju informon për sa më poshtë vijon:

Rezulton se, aktualisht, në Autoritetin Portual Durrës janë duke u trajtuar zhvillime të rëndësishme infrastrukturore dhe operationale, konkretisht lidhur me zhvendosjen e Portës 4.

Kjo zhvendosje lidhet drejtpërdrejt me mënyrën e organizimit të hyrje-daljeve, kontrollin e aksesit, qarkullimin e mjeteve dhe personave, si dhe me flukset operationale të ndërrmarra.

Porta 4 përbën një pikë kyçe në funksionimin e përditshëm të APD-së, pasi ndërvepron me disa procese dhe sisteme ekzistuese, të cilat mund të jenë objekt integrimi apo dixhitalizimi në kuadër të projektit "Digital Port". Për rrjedhojë, çdo ndryshim në vendndodhjen, infrastrukturën mbështetëse, skemën e funksionimit apo organizimin operacional të kësaj porte mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përcaktimin e nevojave teknike dhe funksionale të procedurës.

Në këtë fazë, vijimi i procedurës "Digital Port" pa pasur të qartësuar dhe konsoliduar konfigurimin e ri të Portës 4 mund të krijojë paqartësi në lidhje me objektin e prokurimit, Gjithashtu, duke qenë se për “Zhvendosjen e Portës 4” është parashikuar një procedurë/projekt i veçantë me objekt “Zhvendosja e Portës 4 / Projektim-Zbatim”,ekziston risku që procedura “Digital Port” të mbivendoset me këtë projekt, ose të kërkojë ndryshime të mëvonshme gjatë fazës së zbatimit, nëse realizohet përpara qartësisimit të plotë të nevojave reale që do të dalin pas zhvendosjes.Vijimi i procedurës në këtë moment mund të sjellë këto risqe kryesore:

- 1. përcaktim jo të plotë ose jo të saktë të nevojave reale teknike dhe operationale;*
- 2. hartim të specifikimeve teknike që mund të mos jenë më të përshtatshme pas ndryshimeve infrastrukturore;*

3. nevojë për ndryshime të mëvonshme në objektin, afatet apo zbatimin e kontratës;
4. mbivendosje me procedurën/projektin e veçantë për zhvendosjen e Portës 4;
5. rritje të kostove, kompleksitetit dhe kohës së zbatimit;
6. vështirësi në integrimin e sistemeve ekzistuese me zgjidhjet e reja dixhitale;
7. risk për mosarritjen e plotë të qëllimit funksional të projektit "Digital Port".

Për këto arsye, vlerësohet se procedura "Digital Port" nuk duhet të trajtohet si procedurë prioritare në këtë moment, por duhet të rishikohet në një fazë të mëvonshme, pasi të jenë qartësuar elementët teknikë, operacionalë dhe infrastrukturorë që lidhen me zhvendosjen e Portës 4.

Procedura e prokurimit "Digital Port" duhet të mos vijohet në këtë fazë, dhe të riplanifikohet për rishikim në një moment të mëvonshëm, pas qartësimit të plotë të projektit për zhvendosjen e Portës 4.

Rishikimi i procedurës duhet të kryhet vetëm pasi të jenë përcaktuar në mënyrë të qartë:

konfigurimi i ri teknik dhe operacional i Portës 4;

pikat reale të aksesit dhe flukset hyrëse/dalëse;

infrastruktura e nevojshme mbështetëse;

sistemet ekzistuese që do të preken ose do të integrohen; kërkesat reale për dixhitalizim Në vijim të komunikimeve të përcjella nga Divizioni i Financës dhe Marrëdhënieve Tregtare, si dhe të kërkesës për rishikimin e procedurave dhe zërave buxhetorë që mund të preken, është marrë në shqyrtim procedura e prokurimit me objekt "Digital Port". Nga komunikimi i administruar; ndikimi në objektin e procedurës dhe në fondin limit.

Ky rishikim do të mundësojë hartimin e një procedure më të saktë, më funksionale dhe më të përshtatur me nevojat reale të Autoritetit Portual Durrës, duke shmangur riskun e specifikimeve të paplota, ndryshimeve të mëvonshme kontraktuale, mbivendosjes me projekte të tjera dhe përdorimit joefikas të burimeve buxhetore.

Për rrjedhojë, procedura "Digital Port" duhet të konsiderohet si procedurë që mund të shtyhet për një fazë të mëvonshme, pa cenuar operimin ditor të ndërmarrjes, ndërkohë që prioritet duhet t'u jepet proceseve dhe ndërhyrjeve emergjente që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin operacional dhe logjistik të APD-së, siç janë zgjerimi i sheshit të TMGJ në funksion të storages së kontenierëve bosh, spostimit të terminalit Auto në kalatën 1 dhe fillim kalatës 0 si dhe shkresës së Kompanive Spedicionere që operojnë portin e Durrësit, administruar në APD me nr. Prot 1386 datë 29.04.2026.

Për sa më sipër Autoriteti Portual Durrës nuk mund të marri në shqyrtim ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik INSTANT.AL.”

II.30. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK në këtë procedurë prokurimi, më datë 15.05.2026 ka dorëzuar argumente shtesë në formë shkresore mbi kundërsimet e vendimit të KSHA-së, protokolluar me tonën me nr.1410/3, datë 21.05.2026 me objekt “Kthim përgjigje”.

II.31. Më datë 02.06.2026 me shkresën nr.1410/4 nga Komisioni i Prokurimit Publik u dërgua kërkesa për informacion të autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit të operatorëve ekonomik ankimues për trajtimin e ankesave të paraqitur nga operatorët ekonomik, “INSTANT.AL” SHPK, “PC STORE” SHPK, “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK për procedurën objekt – ankimi.

II.32. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar ka përcjellë me shkresën nr. 1912/1 prot., datë 05.06.2026, protokolluar me tonën me nr.1410/5 prot., datë 08.06.2026, informacionin e kërkuar nga KPP mbi trajtimin e ankesave të paraqitur nga operatorët ekonomik, “INSTANT.AL” SHPK, “PC STORE” SHPK, “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK.

II.33. Në datën 11.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 1448 protokoli, datë 12.05.2026 e operatorit ekonomik OPTIMA COMMUNICATION” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.34. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1448/1 prot, datë 12.05.2026.

II.35. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka përcjellë me shkresën nr. 1654 prot., datë 15.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1448/2 prot., datë 19.05.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor,

rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës me arsyetimin si për ankesën e parë të operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.

II.36. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK në këtë procedurë prokurimi, më datë 24.05.2026 ka dorëzuar argumente shtesë nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave protokolluar me tonën me nr.1448/4, datë 25.05.2026 me objekt “Formular i paraqitjes së argumentave”. Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK ka dorëzuar përsëri kundërshimet mbi vendimin e KSHA-së, protokolluar me tonën me nr.1410/4, datë 25.05.2026 me objekt “Formular i paraqitjes së argumentave”.

II.37. Në datën 12.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 1465 protokoli, datë 13.05.2026 e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.38. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1465/1 prot, datë 13.05.2026.

II.39. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar “Optima Communication” SHPK në këtë procedurë prokurimi, më datë 14.05.2026 ka dorëzuar argumente për lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.40. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka përcjellë me shkresën nr. 1653 prot., datë 15.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1465/3 prot., datë 19.05.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës me arsyetimin se është paraqitur jashtë afateve.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6631, datë 07.05.2026 dhe me nr. protokolli nr. 1410/2026 prot., datë 07.05.2026 e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, me arsyen se: “...- Për kriterin 2.3.3 /e, i cili parashikon kriterin: e) Te paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. DST përcakton shprehimisht se operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën një specialist të çertifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Operatori ekonomik ka paraqitur certifikata që lidhen me: Oracle Database@AWS Certified Architect Professional Certifikimi Oracle Database@AWS Certified Architect Professional nuk përputhet plotësisht me kompetencat e Oracle Database Administrator sepse është i ndërtuar për teknologji cloud specifike Database@AWS, ndërsa projekti thekson se platforma do të instalohet dhe operojë në infrastrukturën lokale të Autoritetit Portual Durrës (On-Premise). Kërkohej që platforma të instalohet dhe të operojë on premise, kriteri teknik lidhet me aftësitë për administrimin e Oracle Database: instalim, patch & upgrade, backup/recovery me RMAN, multitenant (CDB/PDB), si dhe backup/recovery në kontekst të një serveri lokal, fusha që Oracle i liston si objektiva të certifikimeve të administrimit të databazës. Nga ana tjetër, Oracle Database@AWS funksionon në data center-ët e AWS dhe është ndërtuar mbi integrimin OCI-AWS (Ilogari, IAM, console dhe shërbime AWS). Për këtë arsye, certifikimet e fokusuara në këtë platformë nuk sigurojnë mbulim të plotë praktik për kërkesat e instalimit, konfigurimit dhe operimit të një infrastrukture Oracle në ambientin lokal (on-premise) të institucionit. Ndonëse ky certifikim mund të prekë operim, migrim, HA/DR dhe menaxhim të databazave Oracle, por këto kompetenca janë të lidhura me mjedisin Oracle Database@AWS dhe nuk provojnë drejtpërdrejt kompetencë për instalim, konfigurim dhe operim të një infrastrukture Oracle lokale të institucionit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, të shtojcës 9, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar sipas shtojcës me ndryshimet përkatëse:

“2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të**

raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.***

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimues “INSTANT.AL” SHPK, ka dorëzuar pranë autoriteti kontaktor dokumentacionin fizik si më poshtë:

- Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar: Punonjës

“• Operatori ekonomik “Instant” SHPK, Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: xx

Profili i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelit kryesor kyc të poshtëshënuar, ne listepagese dhe/ose edhe me kontrata sherbimi, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Inxhinier elektronik Inxhinier informatik Inxhinier IT Inxhinier Informatik (programues) ETJ.

Specialistet per kete procedure: sipas kërkesave në pikën 2.3.3

a)Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.(G.Gj)

b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh(G.Gj)

c)Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital (G.Gj)

d)Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital (G.Gj)

e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit (G.Gj).

f)Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital(G.Gj)(Xh.H)

g)Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital (G.Gj)”

- Gjithashtu nëpërmjet dokumentacionit fizik operatori ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK ka dorezuar certifikatat si më poshtë:

Lidhur me kërkesën “e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit”:

(G.Gj)-Oracle University “Oracle Certified Professional”-Oracle Database@AWS Certified Architect Professional.

III.1.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë

një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në

fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e

vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon

si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje

me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: *2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.*
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh..*
- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.*
- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.*
- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit*
- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*
- g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjës të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit të kërkuar në pikën 2.3.3/e të kriterëve të veçanata të kualifikimit, operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit , B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme se ka punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në

kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.1.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimuesi ka deklaruar: 11 punonjës, nga të cilët për pikën e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit (G.Gj). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nëpërmjet certifikatës së dorëzuar e përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për kriterin e) 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit pasi operatori ekonomik ka paraqitur ndër të tjera certifikatën Oracle University “Oracle Certified Professional”-Oracle Database@AWS Certified Architect Professional për punonjësin G.Gj). Ky është një certifikim zyrtar nga Oracle University. Ajo është një certifikatë që vërteton njohuritë në nivel arkitekt Profesional i certifikuar për Oracle Database @ AWS nga Oracle Corporation. Referuar certifikatës së dorëzuar nga operatori ekonomik “INSTANT SHPK” SHPK dhe nga arsyeja e skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe se gjithashtu autoriteti kontraktor vlerëson një procedurë prokurimi për sa është kërkuar në DST. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor ka gjykuar se kriteret e përcaktuara janë të mjaftueshme për realizimin e kontratës me sukses, ajo në asnjë rast nuk mund të vlerësoj (njësisë së prokurimit) duke shtuar kriteret e tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik dhe në rastin konkret vlerësimi i referohet një kriteri të pa kërkuar, pasi në këtë kriter dhe në argumentimin e këtij kriteri kualifikues nuk është përcaktuar asnjë nga funksionet për të cilin është skualifikuar operatori ekonomik ankimues, prandaj për sa dhe është kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriter, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nëpërmjet certifikatës së dorëzuar e përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për kriterin paktën të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “INSTANT” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK për mbajtjen të skualifikuar të operatorit ekonomik PC STORE dhe OPTIMA COMMUNICATION, pasi nuk kanë paraqitur asnjë certifikatë për Oracle Database Administrator dhe nuk kanë provuar përmbushjen e kriterit 2.3.3/e të DST-së dhe sipas arsyeve të konstatuara nga Autoriteti

Kontraktor, KPP gjykon se për sa kohë lidhur me arsyet e skualifikimit të operatoreve ekonomik “PC STORE” shpk dhe “OPTIMA COMMUNICATION” shpk do të shprehet në vijim të këtij vendimit pasi si me sipercituar të 2 operatorët ekonomik “PC STORE” shpk dhe “OPTIMA COMMUNICATION” shpk janë paraqitur me ankesë për të njëjtat arsye dhe pretendime, vlen të mos ripërsëris veten për sa kohë do të ndalet në gjykimin e tyre sipas rradhës së ankesave të paraqitura.

III.3. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6636, datë 11.05.2026 dhe me nr. protokolli nr. 1448/2026 prot., datë 12.05.2026 e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, me arsyen se: *“-Komisioni i Vlerësimit më poshtë paraqet pikat e kriterëve që nuk janë plotësuar nga Operatori Ekonomik: 2.3.3.a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. 2.3.3.d) Të paktën 1 (një) specialist, i certifikuar për baza të dhënash, me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës ‘Porti Digjital. 2.3.3.e) Të paktën 1 (një) specialist, i certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. 2.3.3.f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile, me të cilën do të krijohet platforma e Portit Digjital. 2.3.3.g) Të paktën 1 (një) specialist, i certifikuar për testimin e programeve kompjuterike, me të cilën do të krijohet platforma e Portit Digjital. Komisioni i Vlerësimit ka detyrimin ligjor të vlerësojë jo vetëm ekzistencën formale të dokumentit të paraqitur, por edhe aftësinë e tij provuese për të plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, bazuar në argumentimin e dokumentuar në Dokumentet e Tenderit dhe në dispozitat e ligjeve në fuqi. Më poshtë paraqet arsyet e mosplotësimit të kriterëve.- Për kriterin 2.3.3 /a, i cili parashikon kriterin: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Certifikimet profesionale ITIL, sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, bazohen në procese formale vlerësimi të administruara në mënyrë të kontrolluar dhe të standardizuar, ku kandidati i nënshtrohet një provimi profesional të strukturuar, me qëllim verifikimin e njohurive dhe kompetencave përkatëse. Në certifikimin e kërkuar si ekuivalent, PeopleCert, në cilësinë e ofruesit zyrtar dhe të autorizuar të provimeve ITIL, aplikon modelin e provimeve të mbikëqyrura online (Online Proctored Examinations), i cili garanton zhvillimin e provimeve profesionale në distancë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të integritetit akademik dhe profesional. Sipas udhëzimeve zyrtare të PeopleCert, seanca e provimit zhvillohet nën monitorim të vazhdueshëm, regjistrohet në mënyrë elektronike dhe mbikëqyret nga një proktor i pranishëm online gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit të testimit, duke siguruar mekanizma të verifikimit të identitetit dhe garantimit të besueshmërisë së procesit të vlerësimit. Ky mekanizëm përbën një element thelbësor të procesit të certifikimit profesional dhe përbën kriter dallues midis një certifikimi profesional. Platforma Alison ofron vetëm një certifikatë në përfundim të kursit dhe provimit, pa mbikëqyrje nga një person i autorizuar i platformës. Kjo nënkupton që certifikata e*

Alison.com nuk dëshmon njohuritë e kandidatit sipas ndonjë standardi të matshëm, por ajo vërteton vetëm ndjekjen e materialit online dhe kalimit të një provimi pa mbikëqyrje. Ky proces nuk përfshin një skemë vlerësimi të krahasueshme me provimet profesionale të administruara nga organizata certifikuese të akredituara dhe, rrjedhimisht, nuk përmbush kriteret e certifikimit profesional të strukturuar dhe të kontrolluar. Gjithashtu Alison e përshkruan kursin si “Essentials of IT Service 2 Management and Infrastructure Library Level 4”, që mbulon konceptet bazë të ITIL/ITSM dhe shpjegon se si ITIL 4 mund të përdoret si për menaxhimin e shërbimeve të TI. “Shpjegon kërkesat për çertifikimin ITIL dhe përfitimet e marrjes së tij.” ITIL, pra e trajton certifikimin zyrtar si hap të veçantë, jo si pjesë të vetë kursit. Modulet (framework, SVS, SVC) janë tematikisht të ngjashme me pjesë të moduleve të ITIL 4 Foundation, por janë vetëm trajnim teorik, jo vetë certifikimi zyrtar. Në mënyrë të njëjtë, edhe certifikimi për suport teknik nga Google nëpërmjet platformës Coursera bazohet në përfundimin e një trajnimi dhe në vlerësime të brendshme të kursit, të cilat nuk përbëjnë një proces certifikimi profesional të pavarur, të mbikëqyrur dhe të administruar nga një organ certifikues i akredituar, sipas standardeve të certifikimeve profesionale formale. Vetë certifikata klasifikohet si çertifikim i përfundimit të një kursi online pa kredite. Për rrjedhojë, konstatohet se certifikimet e paraqitura: “Certifikim ITIL nga Alison”, dhe “Certifikim për suport teknik nga Google (Coursera)”, nuk përmbushin kërkesat e një certifikimi profesional, siç parashikohet nga kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e procedurës. Në këto kushte, kriteri 2.3.3/a nuk konsiderohet i plotësuar. - Në lidhje me kriterin 2.3.3/d, i cili parashikon kriterin: Të paktën 1 (një) specialist, i certifikuar për baza të dhënash, me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës ‘Porti Digjital. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, konstaton sa vijon: Si dokument provues është paraqitur “Certifikim Administrator Database nga LinkedIn”. Nga analiza e këtij certifikimi rezulton se platforma LinkedIn Learning, në dokumentacionin dhe politikat e saj zyrtare, e përkufizon certifikatën e lëshuar si “Certificate of Completion”, pra certifikatë përfundimi, e cila gjenerohen automatikisht sapo sistemi konstaton që janë parë të gjitha videot e kursit ose learning path it. LinkedIn Learning sqaron se ky dokument lëshohet pas përfundimit të materialeve mësimore (video, module trajnimi, përmbajtje edukative), pa parashikuar zhvillimin e një provimi formal, të standardizuar dhe të mbikëqyrur, i cili të shërbejë si mekanizëm për vlerësimin e njohurive dhe kompetencave profesionale të kandidatit. Certifikata, në këtë kuptim, lidhet kryesisht me përfundimin e përmbajtjes mësimore dhe jo me një proces formal certifikimi profesional të bazuar në testim të kontrolluar. Në të njëjtën linjë, vetë platforma LinkedIn Learning thekson se përgjegjësia për validimin e përvetësimit të njohurive dhe nivelit të kuptimit i mbetet vetë pjesëmarrësit, çka e përforcon karakterin e certifikimit si dëshmi pjesëmarrjeje dhe përfundimi të një kursi trajnues, dhe jo si certifikim profesional, i administruar nga një organ certifikues. Në vlerësim të këtyre elementeve, Komisioni konstaton se dokumenti “Certifikim Administrator Database nga LinkedIn” nuk përmbush kriteret e një certifikimi profesional për baza të dhënash. Nga analiza e certifikatës “Fundamentals of Database Engineering” nga platforma Udemy komisioni konstaton se kjo platformë lëshon “Certificate of

Completion” pas përfundimit të një kursi, që gjenerohet automatikisht kur përdoruesi përfundon videot dhe materialet. Vetë Udemy deklaron se nuk është institucion i akredituar dhe se certifikatat e saj nuk mund të përdoren si akreditim formal apo certifikim profesionale; ato shërbejnë vetëm si dëshmi që kursi është ndjekur. Për këto arsye certifikimi i paraqitur nga Udemy nuk e përmbushin kriterin. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesën e kriterit 2.3.3/d, i cili kërkon të paktën një specialist të certifikuar profesionalisht për baza të dhënash, mbi të cilën do të ndërtohet databaza e platformës “Porti Digjital”. Në këto kushte, kriteri 2.3.3/d nuk konsiderohet i plotësuar.- Në lidhje me kriterin 2.3.3/e, i cili parashikon kriterin: Të paktën 1 (një) specialist, i certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat 3 ekzistuese të institucionit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, konstaton si më poshtë: Ky certifikim “Oracle Database Administration Certified Professional” merret vetëm pas kalimit të provimeve Oracle Database Administration I (1Z0 082) dhe Oracle Database Administration II (1Z0 083) në përputhje me udhëzuesit zyrtarë të Oracle. Dokumentet e Oracle Certification Path japin qartë strukturën e kësaj skeme, duke treguar se certifikimi në rolin Oracle Database Administrator i përket markës Oracle, me module të përcaktuara dhe provime në qendra të autorizuar, dhe nuk lejon përdorimin e certifikatave të tjera të palëve të treta si zëvendësim brenda këtij programi. Në këtë kontekst, duke qenë se teksti i kriterit nuk hap derë për ekuivalencë, referenca ndaj “Oracle Database Administrator” duhet interpretuar në kuptimin e zakonshëm profesional dhe ligjor, pra si certifikim DBA i lëshuar nga vetë Oracle sipas rrugëve të përcaktuara në Oracle Certification Paths, dhe çdo certifikatë tjetër e brendshme apo institucionale që nuk vjen nga Oracle nuk mund të konsiderohet se përmbush qëllimin e këtij kriteri. Në këto kushte, kriteri 2.3.3/e nuk konsiderohet i plotësuar.- Kriteri 2.3.3/f, i cili parashikon kriterin: Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile, me të cilën do të krijohet platforma e Portit Digjital. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, konstaton sa vijon: Si certifikime janë paraqitur certifikimet e mëposhtme: • Certifikim zhvillues aplikacionesh platformash Web Umbraco nga Udemy • Certifikim zhvillues Web, CSS3 dhe HTML5 nga Alison • Certifikim UX Design nga Google (Coursera) • Certifikim zhvillues Web nga Udemy Nga analiza e certifikatave nga platforma Udemy komisioni konstaton se kjo platformë lëshon “Certificate of Completion” pas përfundimit të një kursi, që gjenerohet automatikisht kur përdoruesi përfundon videot dhe materialet. Vetë Udemy deklaron se nuk është institucion i akredituar dhe se certifikatat e saj nuk mund të përdoren si akreditim formal apo certifikim profesionale; ato shërbejnë vetëm si dëshmi që kursi është ndjekur. Për këto arsye certifikimet e paraqitura nga Udemy nuk e përmbushin kriterin. Platforma Alison ofron vetëm një certifikatë në përfundim të kursit dhe provimit, pa mbikëqyrje nga një person i autorizuar i platformës. Kjo nënkupton që certifikata e Alison.com nuk dëshmon njohuritë e kandidatit sipas ndonjë standardi të matshëm, por ajo vërteton vetëm ndjekjen e materialit online dhe kalimit të një provimi pa mbikëqyrje. Ky proces nuk përfshin një skemë vlerësimi të krahasueshme me provimet profesionale

të administruara nga organizata certifikuese të akredituara dhe, rrjedhimisht, nuk përmbush kriteret e certifikimit profesional të strukturuar dhe të kontrolluar. “Foundations of User Experience (UX) Design” është kursi i parë i programit “Google UX Design Professional Certificate” në Coursera dhe fokusohet në konceptet bazë të UX. Nga faqja zyrtare: kursi ka 4 module të cilat paraqesin konceptet bazë të dizajnit të eksperiencës së përdoruesit, rolin e dizajnerit UX dhe bashkëpunimin me ekipe të tjera në zhvillimin e produkteve. Theksohet qasja te përdoruesi, parimet e dizajnit, aksesueshmëria dhe krijimi i dizajneve të njëtrajtshme në platforma të ndryshme. Përfshihet përdorimi i design sprints për përcaktimin e drejtimit të produktit dhe analiza pas procesit për përmirësim të vazhdueshëm. Gjithashtu trajtohet ndërtimi i një portofoli profesional për paraqitjen e aftësive dhe ekperiencës. Ai është pjesë e një serie prej 8 kursesh që përgatitin për Google UX Design Professional Certificate. Përfundimi i kursit jep një certifikatë përfundimi kursi (certificate of completion) të autorizuar nga Google përmes Coursera (“online non-credit course ‘Foundations of User Experience (UX) Design’ authorized by Google and offered through Coursera”), pra një kredencial mësimor, jo certifikim profesional zhvilluesi në 4 kuptimin teknik. Në kontekstin e kriterit për “specialistë të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile”, ky kurs është i vlefshëm për pjesën e dizajnit të ekperiencës së përdoruesit (UX), por nuk dëshmon aftësi të certifikuara në zhvillim (coding) Web/mobile (arkitekturë, API, backend, siguri, performancë, etj.), dhe vetëm nuk mjafton për ta quajtur kriterin e zhvilluesve Web/mobile të përmbushur. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kriterin për të paktën dy (2) specialistëve të certifikuar profesionalisht për zhvillimin e programeve Web/mobile, për krijimin e platformës së Portit Digjital. Në këto kushte, kriteri 2.3.3/f nuk konsiderohet i plotësuar. - Në lidhje me kriterin 2.3.3/g, i cili parashikon kriterin: Të paktën 1 (një) specialist, i certifikuar për testimin e programeve kompjuterike, me të cilën do të krijohet platforma e Portit Digjital. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, konstaton sa vijon: Si dokumentacion janë paraqitur certifikimet e mëposhtme: • Certifikim softëare testing nga LinkedIn (CompTIA) • Certifikim softëare arkitekture nga LinkedIn • Certifikim softëare testing nga LinkedIn • Certifikim cybersecurity nga Cisco Nga rishikimi i këtyre certifikimeve rezulton se platforma LinkedIn Learning, në faqet zyrtare të ndihmës, e përcakton dokumentin që lëshohet pas përfundimit të një kursi si “Certificate of Completion”, pra certifikatë përfundimi, e cila gjenerohet automatikisht nga sistemi sapo përdoruesi ka përfunduar të gjitha videot dhe materialet e kursit ose të learning path-it. Në të njëjtat dokumente theksohet se kjo certifikatë lëshohet pas përfundimit të përmbajtjes mësimore (video, module trajnimi, materiale edukative) dhe nuk shoqërohet me një provim formal, të standardizuar dhe të mbikëqyrur, që të shërbente si mekanizëm vlerësimi të njohurive dhe kompetencave profesionale në nivel certifikimi; pra roli i saj është të pasqyrojë përfundimin e kursit, jo kalimin e një testi të strukturuar të kompetencës profesionale. Më tej, LinkedIn Learning nënvizon se certifikatat e përfundimit përdoren për të dokumentuar pjesëmarrjen dhe progresin në mësim dhe se vlerësimi i përvetësimit të njohurive varet nga vetë pjesëmarrësi, gjë që e konsolidon përkufizimin e këtij dokumenti si dëshmi përfundimi kursi trajnues, e jo si certifikim

profesional i administruar nga një organ certifikues sipas një skeme formale. Përmbajtja përkatëse mund të verifikohet në faqet zyrtare të LinkedIn Learning, për shembull te udhëzimet për certifikatat e përfundimit në [[https://ëëë\[.\] linkedin\[.\]com/ help/learning/ansWer/a705867](https://ëëë[.] linkedin[.]com/ help/learning/ansWer/a705867)]. Në këtë kuadër, Komisioni konstaton se certifikimet: • “Certifikim softëare testing nga LinkedIn (CompTIA)”, • “Certifikim softëare arkitekture nga LinkedIn”, dhe • “Certifikim softëare testing nga LinkedIn”, nuk përmbushin kriteret e një certifikimi profesional për testimin e programeve kompjuterike të kriterit 2.3.3/g. Në lidhje me “Certifikim cybersecurity nga Cisco”, Komisioni vlerëson si më poshtë: Programi i certifikimit Cisco përbën një sistem të strukturuar dhe të njohur ndërkombëtarisht certifikimi profesional. Megjithatë, nga analiza e objektit dhe fushës së certifikimit rezulton se certifikimi cybersecurity nga Cisco është i fokusuar në fushën e rrjeteve kompjuterike dhe sigurisë kibernetike (cybersecurity), dhe jo në testimin e programeve kompjuterike (softëare testing / softëare quality assurance). Certifikimi cybersecurity nga Cisco ka për objekt: • sigurinë e rrjeteve, • arkitekturën e sigurisë, • mbrojtjen e sistemeve informatike, • menaxhimin e riskut kibernetik, • reagimin ndaj incidenteve të sigurisë, dhe nuk përfshin në mënyrë substanciale kompetenca profesionale të strukturuar për testimin e aplikacioneve softëare. Për rrjedhojë, edhe pse certifikimi nga Cisco përbën një certifikim profesional të vlefshëm në fushën e cybersecurity, ai nuk është i barasvlershëm dhe as i përshtatshëm nga ana funksionale për të përmbushur kërkesën specifike të kriterit 2.3.3/g, i cili kërkon certifikim profesional për testimin e programeve kompjuterike. Në këto kushte, kriteri 2.3.3/g nuk konsiderohet i plotësuar, dhe, në përputhje me dokumentacionin e procedurës kjo sjell skualifikimin e operatorit ekonomik nga procedura e prokurimit.”; Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, të shtojcës 9, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar sipas shtojcës me ndryshimet përkatëse:

“2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.**

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet

të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- i) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.**

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- j) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.**

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- k) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- l) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.***

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- m) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.***

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- n) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të***

raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, ka dorëzuar pranë autoriteti kontaktor dokumentacionin fizik si më poshtë:

- Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar: Punonjës

“• Operatori ekonomik “Instant” SHPK, Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: x

Profili i punonjësve Dizenjator grafik, IT, Matematike, Sipermarres, Punonjes zyre, Sherbime ndihmese, Specialist koordinimi, Specialist marketingu, etj.

E.R– administrator - inxhinjer elektronik - diplome Universiteti Politeknik Tirane - Dega Elektronike, me certifikimet si me poshte:

Pika a)

Certifikim ITIL nga Alison 17 gusht 2024

Certifikim per suport teknik nga Google Coursera 7 shtator 2024

Pika b)

Certifikim per hartim dhe menaxhim projektsh nga Irisoft, 30.09.2023

Certifikim per menaxhim prokektsh nga PMI 25 shtator 2023

Certifikim per menaxhim projektsh nga LinkedIn PMI 23 tetor 2024

Certifikim per menaxhim projektesh nga LinkedIn PMI 20 qershor 2025

Certifikim per menaxhim projektesh nga LinkedIn 20 qershor 2025

Certifikim per menaxhim projektesh nga LinkedIn CPE 20 qershor 2025

Pika c)

Certifikim per sistemet operative dhe servera Linux nga Career Cert Institute date 08.09.2025

Pika d)

Certifikim Administrator database nga LinkedIn 21 tetor 2024

Pika e)

Certifikim per administrimin e databazave oracle nga Career Cert Institute date 15.07.2025

Certifikim per administrimin e programeve Web dhe mobile nga Career Cert Institute date 22.07.2025

Pika f)

Certifikim zhvillues aplikacionesh platformash Web Umbraco nga Udemy 4 shtator 2021

Certifikim zhvillues Web, CSS3 dhe HTML5 nga Alison 6 shtator 2021

Certifikim UX Design nga Google Coursera 21 shkurt 2022

Pika g)

Certifikim softëare testing nga LinkedIn CompTIA 31 janar 2025

Certifikim softëare arkitekture nga LinkedIn 20 janar 2025

Certifikim cybersecurity nga Cisco 21 shkurt 2024

Certifikim softëare testing nga LinkedIn 31 janar 2025

Pika d)

E.B- e diplomuar ne Universitetin e Tiranes – Fakulteti i Shkencave Natyrore – Dega Matematike – punonjese e Optima Communication sh.p.k.

Certifikim inxhinjer database nga Udemy date 01.03.2025

Pika f)

Mbeshtetje te subjekti Endri Dulellari Person Fizik – E.D.– i diplomuar Universiteti I Arteve

Certifikim zhvillues Web nga Udemy 8 tetor 2021

Shoqeruar me angazhimin me shkrim te subjektit

Shenim: per te gjitha deklarimet e mesiperme jemi te gatshem te paraqesim certifikimet dhe listepagesen e muajit te fundit te maturuar sipas ligjit, nga data e hapjes se ofertave, ashtu sic eshte percaktuar ne kerkesat e procedures.”

-Gjithashtu nëpërmjet dokumentacionit fizik operatori ekonomik ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK ka dorezuar certifikatat si më poshtë:

Lidhur me kërkesën “a)Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent”:

(E. R.)- Certifikim ITIL nga Alison 17 gusht 2024, Certifikim per suport teknik nga Google Coursera 7 shtator 2024.

Lidhur me kërkesën “d)Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.”:

(E.R.)- Certifikim Administrator database nga LinkedIn 21 tetor 2024.

Lidhur me kërkesën “e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.”:

(E.R.)- Certifikim per administrimin e databazave oracle nga Career Cert Institute date 15.07.2025.Certifikim per administrimin e programeve Web dhe mobile nga Career Cert Institute date 22.07.2025.

Lidhur me kërkesën “f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital..”:

(E.R.)- Certifikim zhvillues aplikacionesh platformash Web Umbraco nga Udemy 4 shtator 2021.Certifikim zhvillues Web, CSS3 dhe HTML5 nga Alison 6 shtator 2021.Certifikim UX Design nga Google Coursera 21 shkurt 2022.

Lidhur me kërkesën “g)Të paktën paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.”:

(E.R.)-Certifikim softëare testing nga Linkedin CompTIA 31 janar 2025.Certifikim softëare arkitekture nga Linkedin 20 janar 2025.Certifikim cybersecurity nga Cisco 21 shkurt 2024.Certifikim softëare testing nga Linkedin 31 janar 2025.

III.3.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.5.Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik

dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e

vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.6. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.9. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: *2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.***
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh..***
- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.***
- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.***
- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit***
- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.***
- g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.***

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit për të paktën d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital, e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit , f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital, g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital, të kërkuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit , B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.3.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimesi ka deklaruar: punonjës, nga të cilët për pikën “a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent”(E.R)- Certifikim ITIL nga Alison 17 gusht 2024, Certifikim per suport teknik nga Google Coursera 7 shtator 2024. Lidhur me pikën “d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.”:(E.R)- Certifikim Administrator database nga LinkedIn 21 tetor 2024. Lidhur me pikën “e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.”:(E.R)- Certifikim per administrimin e databazave oracle nga Career Cert Institute date 15.07.2025. Certifikim per administrimin e programeve Web dhe mobile nga Career Cert Institute date 22.07.2025. Lidhur me pikën “f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.”(E.R)- Certifikim zhvillues aplikacionesh platformash Web Umbraco nga Udemy 4 shtator 2021. Certifikim zhvillues Web, CSS3 dhe HTML5 nga Alison 6 shtator 2021. Certifikim UX Design nga Google Coursera 21 shkurt 2022. Lidhur me pikën “g) Të paktën paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.”:(E.R)- Certifikim softëare testing nga LinkedIn CompTIA 31 janar 2025. Certifikim softëare arkitecture nga LinkedIn 20 janar 2025. Certifikim cybersecurity nga Cisco 21 shkurt 2024. Certifikim softëare testing nga LinkedIn 31 janar 2025. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe se gjithashtu autoriteti kontraktor vlerëson një procedurë prokurimi për sa është kërkuar në DST. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor ka gjykuar se kriteret e përcaktuara janë të mjaftueshme për realizimin e kontratës me sukses, ajo në asnjë rast nuk mund të vlerësoj (njësisë

së prokurimit) duke shtuar kriterë të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik dhe në rastin konkret vlerësimi i referohet një kriteri të pa kërkuar, pasi në këtë kriter dhe në argumentimin e këtij kriteri kualifikues nuk është përcaktuar asnjë nga funksionet për të cilin është skualifikuar operatori ekonomik ankimues. operatori ekonomik ankimues nëpërmjet certifikatës së dorëzuar e përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për pikat a), d), e), f), g) për të cilat ishte skualifikuar nga autoriteti kontaktor. Referuar certifikatave të dorëzuar nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK dhe nga arsyëja e skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nëpërmjet certifikatës së dorëzuar e përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për pikat a,d,e,f,g.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6645, datë 12.05.2026 dhe me nr. protokolli nr. 1465/2026 prot., datë 13.05.2026 e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, me arsyen se: “--Kriteri 2.3.3/a i kualifikimit i parashikuar në dokumentet e tenderit: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrtarët tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrtarët tatimorë taksativë. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime. Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent është vendosur për të siguruar që operatori ekonomik të zotërojë njohuritë dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në administrimin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve IT. Në kuadër të projektit “Digital Port”, menaxhimi korrekt i shërbimeve IT është thelbësor për garantimin e vazhdimësisë së komunikimeve, standardizimin e proceseve, menaxhimin e incidenteve dhe rritjen e efikasitetit operacional. Një specialist i certifikuar ITIL ose ekuivalent, siguron që proceset e shërbimeve të teknologjisë së informacionit të jenë të dokumentuara, të kontrolluara dhe të përmirësohen vazhdimisht sipas praktikave të standardizuara, duke reduktuar rreziqet dhe ndërprerjet në funksionimin e sistemit të telefonisë. Ky kriter është proporcional dhe në përputhje me natyrën e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve që do të ofrohen. Nga verifikimi i burimeve publike të disponueshme, (adresës: <https://alison.com/about/accreditation> dhe

<https://alison.com/course/foundations-of-til-4-for-service-management>) programi paraqet karakteristikat e mëposhtme: Programi "Foundations of ITIL 4 for Service Management" i Alison.com është një kurs online i nivelit të mesëm i cili zgjat 3 - 4 orë, i akredituar nga CPD UK - një organizatë e pavarur britanike që vërteton procesin e dizajnit të kurseve. Certifikata e lëshuar nga platforma është një certifikatë e Alison.com. Vetë platforma e karakterizon kursin e ndjekur si "fillimi i rrugës drejt certifikimit zyrtar ITIL 4". Elementi teknik themelor që dallon një certifikim profesional ITIL nga certifikata e ofruar nga Alison është provimi i akredituar. Certifikata zyrtare ITIL 4 Foundation lëshohet vetëm pas kalimit të provimit zyrtar, i cili ka parametra të standardizuar:

- 40 pyetje me shumë zgjedhje
- Nota kalimi: 65% (minimum 26/40 pyetje të sakta)
- Kohëzgjatja: 60 minuta, pa materiale ndihmëse (closed-book)
- Mbikëqyrje aktive nga prokurator të certifikuar (Web-proctored)

Platforma Alison ofron vetëm një certifikatë në përfundim të kursit dhe provimit, pa mbikëqyrje nga një person i autorizuar i platformës. Kjo nënkupton që certifikata e Alison.com nuk dëshmon njohuritë e kandidatit sipas ndonjë standardi të matshëm, por ajo vërteton vetëm ndjekjen e materialit online dhe kalimit të një provimi pa mbikëqyrje. Vetë platforma e karakterizon kursin si "fillimi i rrugës drejt certifikimit zyrtar ITIL 4" (start your journey toward globally recognised 2 ITIL 4 certification). Ky formulim tregon se nga pikëpamja teknike, ky kurs është material përgatitor, jo certifikim i plotësuar, dallim i cili vjen direkt nga Alison.com dhe jo nga interpretimi i komisionit të vlerësimit. Për të gjitha arsyet teknike të mësipërme, certifikata e kursit "Foundations of ITIL 4 for Service Management" e Alison.com nuk mund të konsiderohet ekuivalente me certifikimin ITIL sipas kriterit të kërkuar në procedurë.- Kriteri 2.3.3/b i kualifikimit i parashikuar në dokumentet e tenderit: Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E-SIG të raportuara në zyrat e tatimit taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime. Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në menaxhimin e projekteve është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik zotëron kapacitetet profesionale për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin në mënyrë të strukturuar të projektit "Digital Port". Ky projekt përfshin ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese të komunikimit të Autoritetit, integrimi me sistemet aktuale dhe migrim konfigurimesh të ndjeshme, që kërkojnë ndjekje sipas metodologjive të standardizuara të menaxhimit të projekteve (p.sh. PMI, PRINCE2, IPMA). Prania e një specialisti të certifikuar siguron përdorimin e praktikave të mira për menaxhimin e afateve, burimeve dhe rreziqeve teknike, duke garantuar përfundimin me sukses dhe brenda standardeve të cilësisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Nga verifikimi i burimeve publike të disponueshme, (adresës: www.ibm-institute.com/project-management-program/) programi paraqet karakteristikat e mëposhtme: Lloji: Kurs online. Numri i moduleve: 4 module. Kohëzgjatja për modul: 2 orë. Kohëzgjatja totale: Rreth 8 orë. Niveli i deklaruar : Introductory (Hyrës / Fillestar). Kërkesat e hyrjes: pa kërkesa paraprake. Vlefshmëria: Lifetime access (i pakufizuar në kohë). Dokumenti i lëshuar Program Diploma (Diplomë programi) në format PDF. Struktura

kurrikulare e programit: Programi përbëhet nga 4 module, me përmbajtjen e mëposhtme: Struktura kurrikulare e programit: • Moduli I - Basics of Project Management (Niveli: Hyrës) Njohuri të bazave të menaxhimit të projekteve: faza e inicimit, planifikimit, ekzekutimit dhe mbylljes. Mjetet e trajtuara: Gantt Chart, PERT Chart, Critical Path Method. Metodologjitë: Agile, Scrum, Kanban. • Moduli II - Risk Management (Niveli: Hyrës) Konceptet bazë të identifikimit, vlerësimit dhe reagimit ndaj rreziqeve. Procesi: identifikim, vlerësim, parandalim, sigurim, zbutje dhe rimëkëmbje. • Moduli III - Change Management (Niveli: Hyrës) Modelet e menaxhimit të ndryshimit sipas Kurt Leëin dhe John Kotter. Aftësi: strategji, plane veprimi, vlerësim i zbatimit. • Moduli IV - Leadership and Team Development (Niveli: Hyrës) Stile leadership, dinamika e ekipit, fazat e zhvillimit të ekipit. Teknika dhe mjete praktike të menaxhimit të ekipeve. Procesi i lëshimit të certifikatës Faqja zyrtare e programit deklaron shprehimisht mekanizmin e lëshimit të certifikatës në termat e mëposhtme (https://ëëë.ibm_institute.com/help/#1533557970854-c638dc92-3665): "To gain your personal course certificate, you have to complete an online course and a short quiz. All of our course quizzes are multiple choice. Don't ëorry – you can retake the quiz several times free of charge. Also, there is no time limit for completing the course or the quiz. You ëill receive your certificate as a digital file (pdf). We do not send hard copies." Nga ky tekst rezulton: Lëshimi i certifikatës bazohet në plotësimin e kursit dhe kalimin e një testi me shumë zgjedhje (multiple-choice quiz). • Testi mund të ripërsëritet pa kosto dhe pa kufizim radhësh deri në kalim. • Nuk ka kufizim kohor për plotësimin 3 e kursit ose kalimin e testit. • Dokumenti lëshohet si skedar PDF dixhital, pa kopje fizike zyrtare. • Nuk parashikohet asnjë mekanizëm mbikëqyrjeje ose verifikimi identiteti gjatë testimit. Komisioni i Vlerësimit, bazuar në informacionin e disponueshëm, del në përfundimin: Kriteri 2.3.3/b i dokumenteve standarde të tenderit ëstë formuluar me qëllimin specifik që operatori ekonomik të dëshmojë një kapacitet profesional të mirëfilltë për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e projektit. Kjo nuk nënkupton thjesht përvetësimin të disa njohurive teorike të nivelit hyrës. Përkundrazi, ai kërkon dëshmimin e një kompetence nga organizata ose organe certifikuese të akredituara, të cilat operojnë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare. Këto standarde kërkojnë zakonisht përmbushjen e disa kushteve, si edukimi paraprak, përvoja specifike dhe kalimi i testimeve të standardizuara e të mbikëqyrura. Një dokument kualifikimi i lëshuar pas përfundimit të një kursi online dhe përkufizohet zyrtarisht si nivel fillestar (introductory), ëstë i pamjaftueshëm për të verifikuar kompetencat e një profesionisti në këtë fushë. Pranimi i një dokumenti të tillë do të cenonte thelbin e këtij kriteri. Sipas argumentimit zyrtar të Autoritetit Kontraktor, ky kusht kualifikues ëstë vendosur për të garantuar përdorimin e "praktikave të mira për menaxhimin e afateve, burimeve dhe rreziqeve teknike". Një dokument që nuk dëshmon thellësi teknike nuk i ofron Autoritetit Kontraktor asnjë garanci për mbarëvajtjen dhe menaxhimin e duhur të projektit. Gjithashtu vetë procesi i lëshimit të kësaj certificate sipas të dhënave të deklaruara nga vetë faqja zyrtare e institucionit lëshues, procesi i testimit nuk parashikon asnjë mekanizëm për mbikëqyrjen e kandidatit apo për verifikimin e identitetit të tij gjatë zhvillimit të provimit. Për më tepër, vlerësimi mund të ripërsëritet pa asnjë kufizim në numrin e përpjekjeve, deri në kalimin e tij. Kjo mungesë e plotë e masave të sigurisë diskrediton integritetin e vlerësimit. Komisioni i Vlerësimit konkludon se

ky dokument nuk mund të pranohet si provë e vlefshme për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të kualifikimit për specialistin e certifikuar në menaxhimin e projekteve.- Kriteri 2.3.3/c i kualifikimit i parashikuar në dokumentet e tenderit: Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime. Kërkesa për të paktën një specialist të certifikuar në sisteme operative serverash (Windows Server ose Linux) përbën një kriter teknik minimal dhe të domosdoshëm për garantimin e funksionimit të sigurt të projektit të “Digital Port”. Duke qenë se platforma do të instalohet dhe operojë mbi një mjedis serverash enterprise, konfigurimi i pasaktë ose administrimi nga personel jo i kualifikuar mund të shkaktojë probleme të rënda operationale, ndërprerje të shërbimeve, vulnerabilitete të sigurisë dhe rrezik për integritetin e të dhënave. Certifikimet zyrtare si MCSA/MCSE, RHCSA/RHCE, CompTIA Linux+, apo ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht, sigurojnë që specialisti zotëron njohuritë e standardizuara dhe kompetencat e nevojshme për instalimin, konfigurimin, hardening, monitorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së serverëve. Për këtë arsye, kriteri është i arsyeshëm, proporcional dhe në përputhje me praktikën më të mirë për projekte të rëndësishme kritike, duke garantuar stabilitet, siguri dhe vazhdimësi të shërbimit të platformës së Portit Digjital. Në dokumentet e tenderit është përcaktuar qartazi se operatori ekonomik duhet të disponojë personel teknik të kualifikuar për administrimin e sistemeve 4 operative të serverëve, mbi të cilët do të instalohet dhe do të funksionojë platforma objekt kontrate. Ky kriter është thelbësor për garantimin e funksionimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të sistemit dhe përbën kriter përjashtues. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesi rezulton se janë paraqitur: • Certifikim Windows Server 2008 (MCITP); • Certifikim Azure Administrator. Komisioni vëren se certifikimi MCITP për Windows Server 2008 lidhet me një version të amortizuar të sistemit operativ, i cili nuk gëzon më mbështetje zyrtare nga prodhuesi. Një certifikim i lidhur me një OS të dalë nga mbështetja zyrtare nuk garanton njohuri të përditësuara për veçoritë, arkitekturën dhe praktikën bashkëkohore të administrimit të kërkuara për realizimin e kontratës. Vetë Microsoft ka kaluar nga certifikimet tradicionale “produkt qendrore” (si MCITP/MCSA/MCSE) në certifikime të bazuara në role sipas shërbimeve moderne cloud dhe on prem. Për rrjedhojë, ky certifikim nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të vërtetuar kompetencë aktuale në administrimin e sistemeve operative serverash. Gjithashtu, certifikimi Azure Administrator ka në fokus administrimin e burimeve në platformën Microsoft Azure, pra në një mjedis cloud, jo për administrimin klasik të OS-it në server fizik apo virtual on premises. (Windows Server/Linux ose ekuivalent). Edhe pse ky rol mund të përfshijë krijimin dhe menaxhimin e VM-ve në Azure, fokusi qëndron tek menaxhimi i platformës cloud dhe jo tek konfigurimi, hardening-u dhe mirëmbajtja e drejtpërdrejtë e OS-it në servera enterprise, siç kërkohet shprehimisht nga kriteri teknik i tenderit. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton asnjë certifikim, dëshmi apo provë

tjetër që vërteton disponimin e një specialisti për administrimin e OS (Windows Server/Linux ose ekuivalent), element i kërkuar shprehimisht nga kriteri teknik. Në kushtet kur kriteri parashikon qartë nevojën për specialist për administrimin e sistemeve operative serverash (Windows Server / Linux ose ekuivalent), mungesa e provave për njohuri dhe kualifikim në administrimin OS (Windows Server/Linux ose ekuivalent), përbën mosplotësim të drejtpërdrejtë të kriterit dhe nuk mund të konsiderohet e zëvendësueshme apo ekuivalente me certifikime të natyrës tjetër. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e kualifikimit teknik për disponimin e specialistit për sisteme operative serverash OS (Windows Server/Linux ose ekuivalent).- Kriteri 2.3.3/e i kualifikimit i parashikuar në dokumentet e tenderit: Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatimit taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime. Integrimi i platformës së “Digital Port” me databazat ekzistuese të institucionit kërkon domosdoshmërisht angazhimin e të paktën një specialisti të certifikuar në Oracle Database Administrator, pasi infrastruktura aktuale e të dhënave e Autoritetit Portual Durrës bazohet kryesisht në teknologjinë Oracle dhe ndërvepron me sisteme kritike si Oracle JDE, PCS, modulet financiare dhe shërbime të tjera operative. Certifikimi Oracle garanton që specialisti ka njohuritë dhe kompetencat e duhura për të siguruar integrim të sigurt, të saktë dhe të qëndrueshëm ndërmjet aplikacioneve të reja Web/mobile dhe databazave aktuale. Ky rol është thelbësor, sepse procesi i integritetit përfshin konfigurime të ndërlikuara të skemave, optimizim të komunikimit midis aplikacioneve dhe databazës, menaxhim të lidhjeve (connection pooling), krijim të API-ve, procedurave të ruajtura dhe mekanizmave të avancuar të kontrollit të aksesit. 5 Vetëm një administrator i certifikuar Oracle është në gjendje të sigurojë që këto operacione kryhen sipas standardeve zyrtare të Oracle, duke garantuar integritetin e të dhënave, performancë të lartë në kushte ngarkese intensive dhe kompatibilitet të plotë me strukturat aktuale të institucionit. Një person me certifikim Oracle kupton dhe aplikon në mënyrë korrekte praktikën e sigurt të zhvillimit dhe integritetit, duke shmangur rreziqet që lidhen me query-t joefikase, konfigurimet e gabuara, problemet e transaksioneve dhe cenimin e sigurisë së të dhënave. Ai është i domosdoshëm edhe për menaxhimin e migrimeve, sinkronizimeve, auditimit dhe proceseve të rikuperimit në rast avarie, të cilat janë kritike për funksionimin 24/7 të platformave të portit. Kërkesa për një specialist të certifikuar në Oracle Database Administrator nuk është vetëm kriter teknik, por një garanci e drejtpërdrejtë se integriteti midis aplikacioneve Web/mobile dhe databazave ekzistuese do të realizohet në mënyrë profesionale, të sigurt dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të Oracle, duke mbrojtur stabilitetin e sistemeve të institucionit dhe cilësinë e shërbimit për përdoruesit. Në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) është përcaktuar shprehimisht kërkesa që operatori ekonomik të disponojë Oracle Database Administrator, si personel kyç teknik për realizimin e kontratës. Ky kriter është

kategorizuar si kritik, për shkak të rolit themelor që administrimi i databazës ka në funksionimin, sigurinë, integritetin dhe performancën e platformës objekt kontrate. Certifikimi “Oracle ERP – Fundamental Concepts & Principles” i ofruar nga Alison ka fokus me softuerin Oracle ERP, arkitekturën Oracle E-Business Suite, fazat e implementimit të një sistemi ERP dhe dallimet ndërmjet Oracle EBS dhe Oracle ERP Cloud, përmes një kursi online me kohëzgjatje rreth tre orë dhe përfundim të vërtetuar nga një certifikatë e platformës Alison, pa një provim të strukturuar. Ky certifikim nuk përfshin dhe nuk provon njohuri apo aftësi në fushën e administrimit të databazës Oracle, e cila përfshin, ndër të tjera:

- Administrimin e instancave Oracle Database;
- Menaxhimin e strukturave të databazës;
- Tuning dhe optimizim performance;
- Backup, restore dhe recovery;
- Menaxhim të përdoruesve, roleve dhe privilegjeve;
- Siguri, auditim dhe integritet të të dhënave;
- Monitorim dhe menaxhim të incidenteve kritike.

Komisioni vlerëson se Oracle ERP User/Functional knowledge dhe Oracle Database Administration (DBA) janë fusha teknikisht të ndryshme, me role, përgjegjësi dhe kompetenca krejtësisht të ndara. Njohuritë në përdorimin e një aplikacioni ERP nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë ekuivalente me aftësitë e nevojshme për administrimin e thellë të databazës Oracle. Për rrjedhojë, certifikimi i paraqitur nuk garanton dhe nuk mbulon kërkesat teknike që lidhen me funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të databazës së sistemit. Paraqitja e një certifikimi që lidhet me ERP dhe jo me administrimin e databazës Oracle përbën mos-përputhje të drejtpërdrejtë me kriterin e kërkuar. Kjo situatë përfaqëson një rast tipik të mosplotësimit substancial të kriterit të kualifikimit teknik, pasi:

- Nuk kemi mospërputhje formale apo mungesë dokumenti;
- Por kemi mungesë reale dhe thelbësore të kompetencës së kërkuar.

Argumentet e paraqitura për platformën Alison në kriteret e tjera të këtij procesverbali mbeten të vlefshme edhe për këtë certifikim, pasi ai është lëshuar nga e njëjta platformë dhe i nënshtrohet të njëjtave standarde dhe procedura verifikimi. Për rrjedhojë, vlerësimi i bërë më parë për besueshmërinë dhe vlefshmërinë e platformës zbatohet në mënyrë të njëjtë edhe në këtë rast. Në përfundim, Komisioni konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur prova të vlefshme për disponimin e një Oracle Database Administrator, sipas kërkesës së përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit.- Kriteri 2.3.3/f i kualifikimit i parashikuar në dokumentet e tenderit: Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të 6 krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime. Zhvillimi i platformës së “Digital Port” kërkon domosdoshmërisht angazhimin e të paktën dy specialistëve të certifikuar në zhvillimin e aplikacioneve Web dhe mobile, pasi projekti përfshin një arkitekturë të ndërlikuar me module të shumta, integritet të avancuara dhe volum të lartë funksionalitetesh që nuk mund të realizohen vetëm nga një individ. Këta specialistë duhet të kenë certifikime ose kualifikime ekuivalente në teknologjitë bashkëkohore të zhvillimit, me qëllim që platforma të ndërtohet duke respektuar standardet ndërkombëtare të cilësisë, sigurisë, performancës dhe shkallëzueshmërisë.

Përmasat e projektit, natyra kritike e operacioneve portuale dhe nevoja për të zhvilluar module të ndryshme si dhe shërbimet API, kërkojnë një ekip minimal prej dy zhvilluesish të specializuar që mund të punojnë paralelisht, të ndajnë përgjegjësitë sipas profileve (backend, frontend, mobile) dhe të sigurojnë vijimësi të punës gjatë gjithë fazave të projektit. Prania e të paktën dy specialistëve ofron stabilitet në zhvillim, shmang varësinë nga një person i vetëm, garanton mbulim të teknologjive të ndryshme dhe mundëson testim, verifikim dhe validim më të sigurt të kodit përpara vendosjes në prodhim. Gjithashtu, zhvillimi i një platforme të tillë kërkon njohuri të thelluara në sigurinë kibernetike, në arkitektura moderne si microservices, në zhvillimin e API-ve, në performancën e aplikacioneve mobile dhe në UX/UI, të cilat nuk mund të mbulohen nga një specialist i vetëm. Dy zhvillues të certifikuar sigurojnë që standardet e kodimit, dokumentimit dhe mirëmbajtjes të respektohen, duke garantuar që platforma jo vetëm do të funksionojë siç duhet në momentin e dorëzimit, por edhe do të jetë e qëndrueshme dhe e shkallëzueshme në të ardhmen. Kërkesa për të paktën dy specialistë të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile përbën një kriter objektiv profesional dhe teknik, i domosdoshëm për të garantuar cilësi, siguri dhe besueshmëri të plotë në ndërtimin e platformes së Portit Digjital, si dhe për të siguruar një projekt të suksesshëm që respekton standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e institucionit. Në analizë të certifikimeve të paraqitura, diploma “Diploma in DevOps Engineering - Kubernetes, Docker and Google Cloud” (Alison) fokusohet në konceptet e microservices, kontenierizimin dhe orkestrimin përmes Kubernetes dhe Docker, si dhe vendosjen e aplikacioneve në Google Cloud. Thelbi i kursit qëndron te shtresa DevOps, arkitektura e microservices dhe operacionalizimi i aplikacioneve në cloud, jo te programimi i vetë aplikacioneve Web/mobile (front end, back end, gjuhë programimi apo frameëork e UI). Për rrjedhojë, kjo diplomë nuk është e mjaftueshme si certifikim që dëshmon aftësi programimi në kuptimin e kërkuar nga kriteri. Certifikata “Beginner Web Development Processes and Server Setup” (Alison) fokusohet kryesisht në njohuritë bazë për funksionimin e internetit, paketat e të dhënave, protokollet HTTP/HTTPS, llojet e hostimit Web, menaxhimin e emrave të domain-eve, përdorimin e serverëve testues dhe konceptet bazë të gjuhëve të kodimit dhe integritit të bazave të të dhënave. Megjithatë, ky certifikim nuk trajton zhvillimin e aplikacioneve Web ose ndërtimin e projekteve komplekse të këtyre aplikacioneve. Certifikata “IT Management – Softëare and Databases” (Alison) fokusohet në rolin e menaxherit në ndërtimin dhe implementimin e sistemeve të informacionit, llojet e softuerit, zhvillimin e gjuhëve programuese dhe sistemeve operative, si dhe konceptet e modelimit të të dhënave dhe menaxhimit të databazave. Edhe pse ky kurs mbulon njohuri 7 konceptuale mbi softuerin dhe databazat dhe ka lidhje me shtresën e të dhënave në aplikacionet Web/mobile, ai nuk përfshin programim konkret, nuk trajton gjuhë apo frameëork e specifike Web/mobile dhe nuk mund të konsiderohet certifikim i mjaftueshëm në zhvillimin e programeve Web/mobile. Certifikimi “OneLogin Technical Specialist” (One Identity) dëshmon njohuri bazë në fushën e menaxhimit të identitetit dhe aksesit (IAM), përfshirë konfigurimin e shërbimeve OneLogin, SSO, federimin e identitetit dhe politikat e aksesit. Ky certifikim lidhet me mënyrën se si aplikacionet Web integrohen me një zgjidhje IAM për të siguruar autentikim dhe autorizim, por fokusi i tij është konfigurimi dhe administrimi i platformës OneLogin, jo zhvillimi i kodit të aplikacioneve

Web/mobile. Për këtë arsye, ai mund të konsiderohet si kompetencë komplementare në fushën e sigurisë, por nuk përbën vetë certifikim në zhvillim Web/mobile. Certifikimi “Microsoft Platform Management Sales Accreditation” (Quest) është një akreditim i orientuar drejt rolit të shitjes për produktet e Quest në ekosistemin Microsoft (Active Directory, Azure AD, Microsoft 365, etj.), duke trajtuar vlerën, skenarët e përdorimit dhe pozicionimin e produkteve. Ai nuk përmban elemente programimi, nuk merret me projektimin e API ve, UI/UX apo logjikës së biznesit dhe shërben si certifikim funksionalisht i dobishëm për role komerciale ose konsulencë shitjesh, jo për rolet e zhvilluesve. Certifikimi “Microsoft Certified: Azure Administrator Associate” mat aftësi në menaxhimin e identiteteve dhe qeverisjes në Azure, shërbimeve të ruajtjes, burimeve të llogaritjes, rrjeteve virtuale si dhe monitorimit, backup it dhe rikuperimit në mjediset Azure. Ky është një certifikim tipik administrimi cloud, i orientuar drejt implementimit, menaxhimit dhe monitorimit të infrastrukturës ku ekzekutohen aplikacionet, por jo drejt programimit të vetë aplikacioneve Web/mobile. Ai mund të vlerësohet si certifikim komplementar për një profil teknik, por nuk dëshmon aftësi në zhvillimin e kodit, dizejnimin e UI/UX apo zhvillimin e API ve. Argumentet e paraqitura për platformën Alison në kriteret e tjera të këtij procesverballi mbeten të vlefshme edhe për këtë certifikim, pasi ai është lëshuar nga e njëjta platformë dhe i nënshtrohet të njëjtave standarde dhe procedura verifikimi. Për rrjedhojë, vlerësimi i bërë më parë për besueshmërinë dhe vlefshmërinë e platformës zbatohet në mënyrë të njëjtë edhe në këtë rast. Në përfundim, Komisioni konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur prova të vlefshme për disponimin e 2 specialistëve për zhvillim Web/mobile, sipas kërkesës së përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, të shtojcës 9, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar sipas shtojcës me ndryshimet përkatëse:

“2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- o) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”,

“h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021,I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- p) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021,I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- q) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021,I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- r) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- s) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- t) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- u) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data**

e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”

III.4.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimues “PC Store” SHPK, ka dorëzuar pranë autoriteti kontaktor dokumentacionin fizik si më poshtë:

- Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar: Punonjës

- Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

Po [X] Jo []

Nëse, po, numri i punonjësve: xx punonjës

Profili i punonjësve: Administrator, Inxhinier elektronik, Teknik elektronik, etj.

Ne kemi punonjësit e nevojshëm të specializuar/ kualifikuar, si më poshtë:

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent

R.Sh ITIL 4 Fundamentals -Essentials of IT Service Management

A.B. ITIL 4 Fundamentals -Essentials of IT Service Management

b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh.

R.Sh. Project Management me Cert ID 323083-159-869-463

c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.

L.Q. Microsoft Certified IT Professional: Enterprise Administrator on Windows Server 2008 c387-3750

d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital

A.B. Active Directory Management & Security. One Identity of Experts Nr.152784558 IT Management - Softëare and Databases ID: 37383333 Databases - DML Statements and SQL Server Administration ID: 1429-37383333

R.K. Technical Specialist One Identity-One Login ID: 236455268 Microsoft Platform Management QUEST.

Ri.SH. IT Management - Softëare and Databases ID: 1758-23570877

L.Q. Microsoft Certified: Azure Administrator Associate : GFB74E-FE542F

e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.

A.B Oracle ERP -Fundamental Concepts& Principles ID: 5291-37383333

f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.

A.B. Diploma in DevOps Engineering - Kubernetes, Docker and Google Cloud ID: 1696- 37383333 Beginner Web Development Processes and Server Setup ID: 4172-37383333

R.K. Technical Specialist One Identity-One Login ID: 236455268 Microsoft Platform Management QUEST.

R.SH. IT Management - Softëare and Databases ID: 1758-23570877

L. Q. Microsoft Certified: Azure Administrator Associate : GFB74E-FE542F

g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.

A.B Diploma in Softëare Testing ID: 1582-37383333

T.H Softëare Tester ID: 069991213724482”

- Gjithashtu nëpërmjet dokumentacionit fizik operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK ka dorezuar certifikatat si më poshtë:

Lidhur me kërkesën “a)Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent”:

R.Sh. -ITIL 4 Fundamentals -Essentials of IT Service Management.

A.B. -ITIL 4 Fundamentals -Essentials of IT Service Management.

Lidhur me kërkesën “b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh..”:

R.Sh. -Project Management me Cert ID 323083-159-869-463

Lidhur me kërkesën “c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.”:

L.Q. -Microsoft Certified IT Professional: Enterprise Administrator on Windows Server 2008 c387-3750.

Lidhur me kërkesën “e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.”:

A.B Oracle ERP -Fundamental Concepts& Principles ID: 5291-37383333

Lidhur me kërkesën “f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital..”:

A. B. -Diploma in DevOps Engineering - Kubernetes, Docker and Google Cloud ID: 1696-37383333 Beginner Web Development Processes and Server Setup ID: 4172-37383333

R.K. -Technical Specialist One Identity-One Login ID: 236455268 Microsoft Platform Management QUEST.

R.SH. -IT Management - Softëare and Databases ID: 1758-23570877

L.Q. -Microsoft Certified: Azure Administrator Associate : GFB74E-FE542F.

III.4.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë

konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.4.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.4.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë

një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në

fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik

dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e

vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.6. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.4.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës

në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.9. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: *2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf te tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent..*
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh..*
- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.*
- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.*
- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit*
- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*
- g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit për të paktën a) 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent, b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh, c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital, e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit, f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për

zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital, të kërkuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, operatori ekonomik “PC STORE” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit , B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.4.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimuesi ka deklaruar: xx punonjës, nga të cilët për pikën “ Lidhur me kërkesën “a)Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent”:R.Sh. -ITIL 4 Fundamentals -Essentials of IT Service Management. A.B.-ITIL 4 Fundamentals -Essentials of IT Service Management. Lidhur me kërkesën “b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh..”:R. Sh. -Project Management me Cert ID 323083-159-869-463 Lidhur me kërkesën “c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.”:L.Q. -Microsoft Certified IT Professional: Enterprise Administrator on Windows Server 2008 c387-3750.Lidhur me kërkesën “e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve Web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.”:A.B. Oracle ERP -Fundamental Concepts& Principles ID: 5291-37383333Lidhur me kërkesën “f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital..”:A.B. -Diploma in DevOps Engineering - Kubernetes, Docker and Google Cloud ID: 1696- 37383333 Beginner Web Development Processes and Server Setup ID: 4172-37383333 R.K. -Technical Specialist One Identity-One Login ID: 236455268 Microsoft Platform Management QUEST. R.SH. -IT Management - Softëare and Databases ID: 1758-23570877 L.Q. -Microsoft Certified: Azure Administrator Associate : GFB74E-FE542F. Komisioni i Prokurimit Publik nisur nga arsyeja e skualifikimit për pikat a,b,c,e të kriterit 2.3.3 gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe se gjithashtu autoriteti kontraktor vlerëson një procedurë prokurimi për sa është kërkuar në DST. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor ka gjykuar se kriteret e përcaktuara janë të mjaftueshme për realizimin e kontratës me sukses, ajo në asnjë rast nuk mund të vlerësoj (njësisë së prokurimit) duke shtuar kriteret të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik dhe në rastin konkret vlerësimi i referohet një kriteri të pa kërkuar, pasi në këtë kriter dhe në argumentimin e këtij kriteri kualifikues nuk është përcaktuar asnjë nga funksionet për të cilin është skualifikuar operatori ekonomik ankimues. Për sa arsyetuar dhe më sipër operatori ekonomik ankimues nëpërmjet certifikatave të dorëzuara e përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për pikat a), b), c), e), për të cilat ishte skualifikuar nga autoriteti kontraktor. Përsa i përket pikës f) te kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 lidhur me

2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve Web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK ka arritur të vërtetoj se e përmbush këtë kriter vetëm me njërin prej punonjësve të deklaruar konkretisht A.B. - Beginner Web Development Processes and Server Setup ID: 4172-37383333 pasi të deklaruarit e tjerë me anë të certifikatave të dorëzuara nuk arrijn të vërtetojnë certifikimin e kërkuar për zhvillim të programeve Web/mobile. Referuar certifikatave të dorëzuara nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK dhe nga arsyeja e skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nëpërmjet certifikatave të dorëzuara e përmbush pjeshërisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për pikat a,b,c,e,f.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

6. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Instant” SHPK, nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK si dhe nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

